

AKTI I THEMELIT DHE STATUTI

I

SHOQËRISË “ALBA MEDIC Partners” SH.P.K.

Sot në datën 5 prill 2021 në Tiranë, pranë selisë së shoqërisë “Alba Medic Partners”, themeluesi i përcaktuar si më poshtë:

Z. Altin Jusufati i biri i Vullnetit, lindur në qytetin e Fierit, me 12.01.1971, banues në Tiranë, Rruga Sulejman Delvina, Njesia bashkiake 5, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me nr. Personal H10112102B.

Në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, si dhe me parashikimet, e ligjit nr. 55/2018, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, përpiloj si më poshtë Statutin dhe Aktin e Themelimit të **Shoqërisë “ALBA MEDIC Partners” sh.p.k.**

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

Shoqëria “Alba Medic Partners” sh.p.k., bazohet në legjislacionin shqiptar që rregullon pozitën juridike të subjekteve të tilla.

Me këtë Statut rregullohen këto çështje :

- emërtimi i shoqërisë,
- lloji i shoqërisë,
- adresa e selisë së saj,
- periudha e kohëzgjatjes,
- veprimtaria e shoqërisë,
- organet drejtuese,
- emrat dhe adresat e themeluesve,
- procedurat me të cilat mund të ndryshohen rregulloret dhe
- marrëdhëniet juridike ndërmjet themeluesve të Shoqërisë, të drejtat e detyrimet e tyre, aksesin e të tretëve pranë kësaj Klinike dhe menyrën e aplikimit të tyre për partneritet, llojin e partneritetit, rekrutimin apo punësimin e të asociuarve, menyrën e bashkëpunimit me subjekte të tjerë privatë apo shtetërorë, kohëzgjatjen e veprimtarisë, kriteret e karrierës brenda Klinikës nga të interesuarit etj.

Neni 2

Emri, vula dhe selia e Shoqërisë

2.1. Shoqëria është person juridik privat dhe vepron si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Ajo do të paraqitet në qarkullim me emrin **Shoqëria “Alba Medic Partners”**, ose shkurt **“AMP” sh.p.k.**

2.2.Shoqëria në korrespondencën dhe vulën e saj mund të përdorë edhe emrin në gjuhën anglëze **ALBA MEDIC PARTNERS.**

2.3.Vula e shoqërisë është në formë katrore Formohet nga logo e shoqërisë anash, me shkrimi **“Alba Medic”** .

2.4.Vendndodhja e shoqërisë është: Rruga “Ferirt Xhajko,Njesia Bashkiake nr 8,Pall 1,shk1, Tiranë.

Neni 3

VEPRIMTARIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë si objekt kryesor të aktivitetit të saj veprimet e mëposhtme:

1. Veprimtari ne fushen mjeksore,kryesisht ne ate diagnostikuese dhe laboratorike.

Neni 4

REGJIMI JURIDIK I SHOQËRISË

4.1. Shoqëria ka karakteristikat e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar. Veprimtaria e saj bazohet kryesisht në këtë Statut dhe në Aktin e Themelimit, në dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

4.2 Shoqëria bazohet mbi parimet e ekonomisë së tregut. Ajo ka për qëllim që të sigurojë shërbim cilësor për pacientet e saj, si dhe të realizojë fitim nga ky aktivitet.

4.3 Shoqëria fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit përkatës në përputhje me ligjin nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

4.4. Në përputhje me parashikimet ligjore mbi të cilat mbështet veprimtarinë dhe rregullat e vendosura në këtë statut, Shoqëria mund të ndryshojë strukturën apo regjimin juridik të saj.

Neni 5

TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKUT THEMELUES

5.1.Ortaku administron aktivitetin e Shoqërisë në përputhje dhe konform objektit të saj. Gjithashtu, në përputhje me praktikën e mirë, administrohen edhe vlerat intelektuale dhe ekonomiko-financiare të Shoqërisë.

5.2.Ortaku ka dijeni në çdo kohë për gjendjen dhe rezultatin ekonomiko-financiar të Shoqërisë dhe zotëron në çdo kohë të gjithë dokumentacionin me interes të saj.

5.3. Ai ruan të drejtën që në çdo kohë të tërhiqet nga pjesëmarrja në Shoqëri dhe të tjetërsojë pjesën e tij të kapitalit të investuar, në përputhje me rregullat e këtij statuti dhe ligjin përkatës.

5.4. Heqja dorë nga shoqëria nuk e liron ortakun nga detyrimet që ka deri në çastin e heqjes dorë dhe, nuk e ndalon atë në marrjen e të ardhurave përkatëse të siguruar nga shoqëria deri në atë moment.

5.5. Ortaku nuk mund të jetë pjesëmarrës njëkohësisht edhe në Zyra të tjera Ligjore.

Neni 6

Pasuritë e Shoqërisë.

6.1. Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj, janë në pronësi të ortakëve në përputhje me kapitalin themeltar të investuar prej tyre, apo me kontributin për çdo aktivitet të veçantë të ushtruar prej Klinikës

6.2. Me miratim të Mbledhjes së Ortakëve, (kur ajo është formuar), investimi i secilit ortak në pasurinë e Shoqërisë mund të ndryshojë në përputhje me një gjendje të re të krijuar gjatë aktivitetit.

6.3. Ortaku (ët) mbane përgjegjësi për humbjet e krijuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre, deri në kufirin e kontributit të investuar.

Neni 7

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Veprimtaria e Shoqërisë do të shtrihet në një afat të pakufizuar në kohë. Në rast mbarimi të aktivitetit të saj, Shoqëria do të ndjekë të gjitha procedurat e ngjashme që aplikohen nga shoqëritë tregtare për mbylljen e aktivitetit të tyre.

Neni 8

Burimet financiare

8.1. Shoqëria krijon burimet e saj financiare nga ushtrimi i veprimtarisë së saj sipas objektivit të përcaktuar.

8.2. Veprimtaria e funksionimit të Shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut.

8.3. Veprimtaria ekonomike-financiare ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

Neni 9

Kapitali dhe kuotat e Shoqërisë

9.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) lekë, i formuar dhe i nënshkruar në masën 100% nga ortakët i vetëm të shoqërisë **Z. Altin Jusufati** Kapitali ndahet në kuota gjithsej 1 (një) Kuotë me vlerë nominale prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh.

9.2. Ortaku i vetëm i shoqërisë **Z.Altin Jusufati** zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë me vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë.

9.3 Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

9.4. Për vërtetimin e pronësisë mbi kuotat e mësipërme, shoqëria tregtare mund të lëshojë në emër të personit apo të personave që zotërojnë kuotën, një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit.

Neni 10

Pasuria e Shoqërisë

10.1. Pasuritë e Shoqërisë përbëhen nga sendet e kontribuar prej ortakut themelues **Z.Altin Jusufati** dhe nuk janë përfshirë në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

10.2. Në çastin e aderimit të një ortaku të ri në Shoqëri, vlera e pasurive të Shoqërisë do të konsiderohet si kontribut i ortakut themelues dhe në rast se me zhvillimin e aktivitetit do të krijohen pasuri të tjera, atëherë ato do të konsiderohen që janë në bashkëpronësi të ortakëve sipas vlerës së kapitalit që ata kanë investuar.

Neni 11

Kuotat e kapitalit të regjistruar mund të transformohen, tërësisht ose pjesërisht, tek të tretët, vetëm me kontratë me shkrim dhe me miratimin e Asamblesë së Ortakëve me shumicë të cilësuar.

Neni 12

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali themelor mund të zmadhohet apo zvogëlohet me vendim të ortakëve themelues në një mbledhje të veçantë të asamblesë së përgjithshme të ortakëve.

Neni 13

Fondi Rezervë

Shoqëria krijon fondin rezervë për të përballuar nevojat e saj ekonomike. Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerjen e detyrimeve të krijuara nga veprimtaria e saj ekonomike.

Neni 14

Përdorim i të ardhurave

14.1. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;

- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

14.2. E ardhura e krijuar nga aktiviteti i Shoqërisë, pasi zbriten shpenzimet e bera dhe amortizimi i mjeteve të përdorura për çfarëdolloj aktiviteti, pagesat për tatimet dhe taksat vendore, pagat apo shpërblimet për punën e të punësuarve, asistentëve dhe bashkëpunëtorëve të tjerë, pagesat e bëra për rritjen e investimeve në aktivitetin e Shoqërisë, ndahen ndërmjet ortakëve në përputhje me kontributin e tyre.

Neni 15

Pasqyrat Financiare

15.1. Të ardhurat dhe pasuria e Shoqërisë vlerësohet në monedhë të vendit, në përputhje me rezultatet e nxjerra nga ana e ekspertëve kontabël të caktuar për të realizuar përpilimin e pasqyrave financiare.

15.2. Bilanci vjetor duhet të paraqitet brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni tatimor. Forma e pasqyrës financiare të Shoqërisë, përpunohet me formën e miratuar nga ekspertët në Republikën e Shqipërisë.

Neni 16

Asambleja e Përgjithshme

16.1. Organi kryesor i Shoqërisë është Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve. Ajo është e zakonshme dhe e jashtëzakonshme. Mbledhja e jashtëzakonshme mund të mbledhet kur Ortakët apo Administratorët e Shoqërisë e shohin të nevojshme të shqyrtojnë një çështje me rendësi të posaçme.

16.2. Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve mund të shqyrtojë e vendosë për të gjitha çështjet, me përjashtim për ato që statuti ka përcaktuar ndryshe.

16.3. Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve mbledhet të paktën një herë në 6 (gjashtë) muaj. Administratori, në rastet kur thërret mbledhjen, bën njoftimin me shkrim, për secilin ortak.

16.4. Në mbledhje mbahet procesverbal nga një sekretar i caktuar nga administratori.

16.5. Vendimet e marra nga mbledhja arrihen me shumicë të cilësuar të votave të anëtarëve. Nese numri i votave është i barabartë, vendimet merren në bazë të peshës së kuotës që ka secili ortak votues në kuotat e kapitalit të shoqërisë. Vendimet nenshkruhen nga Ortakët e Shoqërisë, si dhe ruhen në arkivin e Klinikës. Vendimeve të marra, u nenshtrohen të gjithë ortakët dhe punonjësit e tjerë të Klinikës.

Neni 17

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

17.1 Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- përcaktimin e politikave të përgjithshme tregtare të Shoqërisë;
- të modifikojë dhe ndryshojë Statutin e Shoqërisë;
- emerimin apo shkarkimin e administratorëve;
- të përcaktojë ekspertë kontabël të miratuar apo likuiduesit e Shoqërisë;
- mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- të përfaqësojë Shoqërinë në Gjykatë si dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- të riorganizojë dhe prishë Shoqërinë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 18

Kompetencat dhe kufizimet

18.1 Në Mbledhjen e Jashtëzakonshme të Asamblesë mund të shqyrtohen dhe vendosen për çështje si më poshtë:

- Miratimi i mbylljes së veprimtarisë së Shoqërisë;
- Miratimi i shtimit/pakësimit të numrit të Ortakëve të Shoqërisë;
- Miratimi i fillimit të procedurave për falimentimin e veprimtarisë së Shoqërisë;
- Miratimin e shtimit të aktivitetit në fushat jashtë veprimtarive ligjore dhe regjistrimet përkatëse sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

18.2. Mbledhja e jashtëzakonshme thirret vetëm nga Ortakët. Ajo ndjek, për aq sa përputhen, të njëjtat rregulla me Mbledhjen e Zakonshme.

Neni 19

Ortakët e rinj

19.1 Mbledhja e jashtëzakonshme e Ortakëve mund të lejojë mbi bazë unanimiteti pranimin e ortakëve të rinj.

19.2. Kriteret e pranimin të ortakëve të rinj përcaktohen rast pas rasti nga Ortakët Themelues, apo edhe Ortakët e bashkuar me vonë atyre. Për çdo rast vlerësohen cilësitë profesionale të kandidatit, fusha e veprimtarisë kryesore të tij, kontributi në mbarëvajtjen e punëve të deri atëhershme të Zyrës, reputacioni publik i tij dhe të tjerë kriteret të vendosura nga Mbledhja e Ortakëve.

19.3. Në rast të shtimit të Ortakëve të rinj, rregullohen edhe marrëdhëniet ekonomike ndërmjet tyre, kuotat dhe kontributi, të cilat pasqyrohen menjëherë në statut.

Neni 20

Administratori

20.1. Administrimi i Shoqërisë do të kryhet nga administratori ose administratorët e Shoqërisë. Ata kanë të drejtat për drejtimin e zakonshëm të Shoqërisë, përveç atyre të drejtave që Ligji apo ky statut kalon Ortakëve të tjerë të Shoqërisë.

20.2. Administratori/Administratorët përfaqësojnë zyrën në marrëdhënie me të tretët si dhe përpara organeve të administratës shtetërore apo ato gjyqësore.

20.3. Administratorët emërohen apo shkarkohen nga detyra e tyre me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

20.4. Administratorët mund të jenë përgjegjës civilisht për dëmet që mund të shkaktojnë gjatë kryerjes së detyrës.

20.5. Administratorët përgjigjen në mënyrë të barabartë përpara Ortakëve për punën e tyre dhe u krijojnë atyre akses në çdo dokumentacion apo punë të Zyrës, kur kërkohet prej tyre.

20.6. Administrator i parë i Shoqërisë Akba Medic Partners, do të jetë **Z.Altin Jusufati** për një periudhë prej 5 vjetësh, me të drejtë riemërimi, duke filluar nga momenti i nënshkrimit të këtij Statuti dhe Akti Themelimi.

20. 7. Administratori gëzon kompetenca të pakufizuara për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që Statuti ia njeh Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 21

Kompetencat e Administratorit

21.1 Administratori ka këto kompetenca kryesore:

- të miratojë planin e veprimtarisë së Klinikës Mjekësore dhe të paraqesë atë për miratim në Mbledhjen e Ortakëve;
- të rekomandojë ndryshime në kapitalin themeltar;
- të rregullojë me akte detyruese raportet e punës brenda Klinikës. Alba Medic
- të përfaqësojë Klinikën Akba Medic në marrëdhënie me të tretët;
- të përcaktojë strukturën e organizimit të Klinikës dhe përpiqet për përzgjedhjen e pjestarëve të saj, jo ortakë;
- të grumbullojë në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike të gjitha materialet teorike apo të jurisprudencës që lidhen drejtpërsëdrejti me mbarëvajtjen e punëve në Klinike;
- të organizojë manuale mbi kriteret e punësimit dhe testime profesionale për të gjithë kandidatët që kërkojnë të punojnë në Klinikën mjekësore Alba Medic
- të gjitha detyrat e tjera që i ngarkohen nga Mbledhja e Ortakëve.

Neni 22

Eksperti kontabël

22.1. Ortakët caktojnë ekspert kontabël për çdo vit financiar. Ai mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e të gjitha llogarive të Shoqërisë.

22.2. Detyra e ekspertit kryhet nga persona të autorizuar nga ligji për veprimtari të tilla.

Neni 23

Punësimi

23.1. Marrëdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen nga kontrata individuale e punës, rregullat e këtij statuti dhe Kodi i Punës.

23.2. Administratori i Shoqërisë përcakton kritere për punësimin e pononjesve të rinj, asistentë dhe punonjësve të tjerë teknikë të Klinikës.

Neni 24

Kontrata Individuale e Punës

24.1 Kontrata individuale e punës duhet të rregullojë:

- Marrjen në punë dhe kushtet e saj;
- Llojin e punës që do të kryhet, profesionet ndihmëse, koha e punës ditore dhe javore, pushimet, shpërblimin për kohën e punës (mujor), shpërblimin për kohën jashtë orarit të punës, festave, ditëve të pushimit, bonuset për punë cilësore;
- Rregulla mbi konfidencialitetin e punës, rregulla të etikës së punës dhe atë të marrëdhënieve me gjykatën apo institucione të tjera;
- Përgjegjësitë e palëve për cënimin e kontratës së punës dhe rregullave të gjithëpranuara të punësimit.

24.2 Të punësuarit mbajnë përgjegjësi civile kur ata, me veprimet e tyre, i shkaktojnë një dëm pasuror aktivitetit të Klinikës.

MBYLLJA E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË. LIKUJDIMI

Neni 25

Veprimtaria e Shoqërisë mund të mbyllet në çdo kohë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Neni 26

Kur Asambleja e Ortakëve merr vendim për mbylljen e veprimtarisë, caktohet një likuidator. Në këto raste përkrah emrit të Klinikës Akba Medic, shënohen edhe fjalët “*në likuidim*”.

Me miratimin e likudimit, Klonika i jep fund veprimtarisë.

Neni 27

Ortakët vendosin mbi rregullsinë e likuidimit, bilancin e likujdimit dhe heqjen e mandatit të likujduesit.

Kur janë kushtet e kërkuara nga Ligji përkatës, Gjykata mund të vendosë për mbylljen e likujdimit me kërkesë të çdo të interesuari.

Aktet e mbylljes depozitohen në QKB.

Neni 28

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

28.1. Ky Statut dhe Akt Themelimi hyn në fuqi ditën që e aprovon themeluesi i Shoqërisë.

28.2. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti bëhen sipas procedurës së njejtë si është aprovuar.

28.3. Për të gjitha çështjet që nuk janë përcaktuar me këtë Statut do të aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

ORTAKU THEMELUES

Z. Altin Jusufati

